



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISE SE QYTETIT KORÇE

Vendim

Nr 92 Date 18.10 2010

Për kalim ne privatizim te banesave shtetere.

Keshilli i Bashkise i Qytetit te Korces,ne mbledhjen e tij te dates se sotme pasi mori ne analize relacionin e paraqitur nga Ndermarrja e Sherbimeve Publike,"Per kalim ne privatizim",mbeshtetur ne Ligjin Nr. 9232 dt.13.05.2004 "Per programet sociale te strehimit te banoreve te zonave urbane" i ndryshuar me ligjin nr.9719 dt.23.04.2007,VKM nr.97 dt.3.2.2008 "Per procedurat e privatizimit te banesave,objekt i ligjit nr.7652 dt.23.12.1992 "Per privatizimin e banesave shtetere dhe i ligjit nr.9321 dt.25.11.2004 "Per privatizimin e banesave dhe objekteve te kthjera ne banesa me fonde e shoqerive dhe ndermarrjeve shtetere",neni 32 pika e e ligjit 8652 dt dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar, VKB Nr.97 date 11.09.2000,mbeshtetur ne kompetencat qe ka si dhe pas diskutimeve te anetareve:

VENDOSI:

1. Te kaloje ne privatizim banesa e ndodhur ne rrugen " Pandi Kereku", pallati 25,lagjja 6,kati i dyte i perbere prej 2 dhoma dhe kuzhine me siperfaqe 71.27 m² nga e cila do te perfitoje familja e z. Amdi Kallo.
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Ndermarja e Sherbimeve Publike.
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARI

Gjergji PENDAVINJI